

KES Publikimet

STANDARDI SOCIAL

&

JETËSOR



INICIATIVA KOSOVARE PER STABILITET
KOSOVAR STABILITY INITIATIVE



Raporti 2

2015

PËRMBAJTJA

HISTORIKU & METODOLOGJIA – fq.1

Projekti – fq.1

Objektivat – fq.1

Qasja dhe metodologjia – fq.2

Mostra e anketimit dhe metodologjia e mostrës – fq.2

GJETJET – fq. 4

Jetesa dhe buxhetet familjare – fq.4

Pritjet për të ardhmen e afërt – fq.10

Përceptimi mbi ndihmën dhe shërbimet sociale – fq.11

KONKLUSIONE & REKOMANDIME – fq. 134

Ky raport është përgatitur në bashkëpunim me stafin e MPMS-së dhe përmbajtja e saj pasqyron kontributet e përbashkëta të kontraktorit dhe homologëve e të saj të ministrisë. Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e projektit për mbështetje të Partnerëve Social të menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe e implementuar nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), sipas kërkesës të së cilës ky hulumtim është kryer.

HISTORIKU & METODOLOGJIA

Projekti

Ky raport është pjesë e aktiviteteve të cilat janë planifikuar për implementimin e projektit “Përkrahje Partnerëve Social” (PPS) i financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Projekti kontribuon në zhvillimin e aftësive dhe njohurive të partnerëve social, hartimin e legjislacionit-hulumtimeve ligjore dhe analizave, forcimin e kapaciteteve administrative dhe menaxhuese të partnerëve social, forcimin e kapaciteteve të partnerëve social në avokim, lobim dhe negociata si dhe në lehtësimin e reformave organizative të partnerëve social.

Raporti është një përkrahje e drejtpërdrejtë në punën e Këshillit Ekonomik dhe Social (KES), i cili me ligj është përgjegjës për lehtësimin e dialogut trepalësh social në vend. Ky raport, që është kontribut i projektit PPS, ofron informacione të mbledhura në terren të cilat janë diskutuar në KES. Mbështetje aktive i është dhënë Sekretariatit të KES-it, e cila e kombinuar me digjitalizimin e materialeve të KES-së, ka për qëllim përmirësimin e menaxhimit të procesit në kuadër të këtij organi.

Projekti është në harmoni me proceset duke marrë parasysh të gjitha ngjarjet e mëdha dhe programet që po ndodhin gjatë periudhës së zbatimit. Qasja e harmonizimit të të gjitha aktiviteteve të projektit, në proceset e vazhdueshme të akterëve shihet si më e përshtatshme për marrjen e rezultateve më cilësore. Disa nga aktivitetet e projektit janë të varura nga proceset dhe bashkëpunimet e akterëve e të cilat nuk mund të zbatohen pa pjesëmarrjen e tyre.

Objektivat

Qëllimi i kësaj ankete me popullsinë e përgjithshme vlerësohet si në vijim:

- Niveli i ndërgjegjësimit publik dhe njohurive mbi politikave sociale;
- Niveli i opinionit publik, qëndrimin ndaj sistemeve të mirëqenies dhe nivelin e mbrojtjes së dëshiruar nga ana e qytetarëve;
- Qëndrim publik ndaj emigrimit të paligjshëm;
- Pritjet dhe qëndrimet e publikut të gjerë drejt politikave sociale dhe të punësimit;
- Shprehjet individuale të kursimeve dhe qëndrimet e publikut të gjerë.

Gjetjet e në këtë hulumtim janë reagime të qytetarëve dhe janë të besueshme për t'u përdorur për vendimmarrje. Këto gjetje, përdoren nga anëtarët e Këshillit Ekonomik Social dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Për këtë arsye, audienca e këtij raporti, janë: përfaqësuesit e institucioneve, organizatat donatore ndërkombëtare, Kuvendi i Kosovës, partitë politike, Organizatat e Shoqërisë Civile, mediat, si dhe publiku i gjerë.

Duke pasur parasysh mungesën e literaturës dhe hulumtimeve lidhur me temat e këtij raporti, informacionet e paraqitura këtu mund të përdoren edhe nga studentët dhe akademikët në punën e tyre.

Qasja dhe metodologjia

Qasja në këtë temë është bërë përmes intervistave të strukturuar, ballë-për-ballë me një mostër prej 1,100 të të anketuarve në tërë Kosovën, e cila është shpërndarë me metodën proporcionale e që pasqyron të dhënat nga regjistrimi i fundit i popullsisë. Mostra prej 1,100 e të anketuarve, është caktuar në 100 vendbanime/fshatra në tërë Kosovën, të cilat janë përzgjedhur nga regjistri i vendvotimeve në Kosovë.

Përzgjedhja është bërë në mënyrë të rastësishme. Është përzgjedhur çdo e njëzeta qendër e votimit/ vendbanimit në listë si dhe duke përdorur metodën në çdo të tretën shtëpi.

Mostra e anketimit dhe metodologjia e mostrës

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) ka dhënë instrumentin pyetësor ndërsa, AnketaCo, ka përkthyer dhe testuar instrumentin/pyetësorin para formës përfundimtare. Pasi që pyetësori i testuar u finalizua, ai më pas është konsideruar si instrument hulumtues i miratuar për kryerjen e studimit.

Metodologjia e propozuar ka prodhuar një mostër që është besnike ndaj realitetit në

terren, pasi që përzgjedhja e të intervistuarve dhe vendbanimeve është bërë në mënyrë të rastësishme. Si rezultat i kësaj, mostra është normalizuar vetë dhe ka karakteristikat e mëposhtme

Sa i përket karakteristikave demografike të të anketuarve, në bazë të statistikave zyrtare të regjistrimit, 66 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se janë të martuar ndërsa 29 për qind e tyre kanë deklaruar se janë beqarë. Statuset tjera sociale janë me përqindje më të ulëta. Në aspektin e madhësisë së familjeve, grupi më i madh në mostër deklaruan se kanë 3 deri në 5 anëtarë (47.9 të anketuarve), pasuar me ato familje që kanë nga 6 deri në 10 anëtarë (42.9 për qind). Kurse, familjet më të vogla (1-2 anëtarë) dhe ato më të mëdha (mbi 11 anëtarë) janë të përfaqësuara me përqindje më të vogla (4.6 për qind dhe 4.8 për qind). Në pyetjen në lidhje me numrin e anëtarëve të punësuar në familje, shumica e të anketuarve kanë raportuar 1-2 anëtar të punësuar.

Vetëm 10 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë 3 deri në 5 anëtarë të familjes të punësuar, ndërsa 25 për qind e të anketuarve deklarojnë se nuk kanë asnjë anëtarë të familjes të punësuar. Figura 2




Figura 1. Karakteristikat e mostrës

paraqet një pasqyrë të plotë vizuale të këtyre tri karakteristikave demografike të mostrës.

Gjendja sociale dhe ekonomike e të anketuarve në mostër, është një reflektim i situatës që konsiderohet se mbizotëron në këtë terren. Në këtë drejtim, 17.7 për qind e të anketuarve kanë të ardhura të përbashkëta familjare prej më pak se 100 euro në muaj. 30.6 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se të ardhurat mujore familjare të tyre janë 100 deri në 300 euro në muaj, ndërsa 28 për qind kanë deklaruar se kanë të ardhura prej 301 deri në 500 euro në muaj. 12.4 për qind e të anketuarve kanë të ardhura mes 501 dhe 800 euro në muaj. Vetëm 5.5 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë të ardhura mujore mes 801 dhe 1000 euro në muaj dhe vetëm 3.1 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se kanë të ardhura familjare prej mbi 1000 euro në muaj.

Situata e kushteve të jetesës në këtë mostër tregon se pjesa më e madhe e të anketuarve jetojnë në shtëpi të cilat janë pronë e tyre (64.3 për qind), e ndjekur nga 21.7 për qind e të anketuarve të cilët jetojnë në shtëpi të prindërve. 8.8 për qind e të anketuarve në mostër jetojnë në banesa, ndërsa 4.5 për

qind e tyre jetojnë në apartamente/shtëpi me qira. Lidhur me nivelin e arsimit e të anketuarve, grupi më i madh në mostër janë ata me arsim të mesëm (50 për qind), pasuar nga ata me arsim fillor (23.7 për qind), ndjekur nga ata me shkollë fillore (23.7 për qind), dhe të diplomuarit në nivelin bachelor (17.1 për qind). Figura 2 jep një pasqyrë të ardhurave të anketuarve, kushtet e jetesës dhe arsimit në detaje.




Figura 2. Të ardhurat, edukimi dhe kushtet e banimit

GJETJET

Jetesa dhe buxhetet familjare

Grupi i parë i pyetjeve përfshin standardin e jetesës dhe mënyrën e jetesës të të anketuarve, përfshirë edhe ato që lidhen me shpërndarjen e buxheteve familjare. Për këtë arsye, të anketuarit u pyetën edhe për shumën e një përqindjeje të përafërt të buxhetit familjarë të shpenzuara për secilën nga kategoritë e renditura në pyetësor.

Këto pyetje janë parashtruar për të nxjerrë informata për mënyrën e jetës që qytetarët e Kosovës e përballojnë si dhe për llojin shpenzimeve që ata bëjnë.

Gjetjet në këtë hulumtim tregojnë se shumica e të anketuarve shpenzojnë kryesisht në mbulimin e nevojave themelore. Shumë pak bëjnë shpenzime në investime afatgjate, aktivitete të kohës së lirë apo luks.

Të gjitha rezultatet janë elaboruar në këtë seksion. Kategoria e parë e shpenzimeve për të cilën anketa ka pyetur respondentët përfshin ushqimin, materialet harxhuese dhe faturat e shërbimeve publike. Për këtë qëllim, 24 për qind e të anketuarve deklarojnë se këto shpenzime përbëjnë 31

deri në 50 për qind e shpenzimeve të përgjithshme. Ushqimi përfaqëson 21 – 30 për qind të shpenzimeve për gati 20% e të anketuarve, ndërsa për më shumë se 13 për qind e të tyre përfaqësojnë 51 – 60 për qind të shpenzimeve. Këto rezultate tregojnë se shumica e qytetarëve buxhetin e tyre e shpenzojnë kryesisht në ushqim për familjet e tyre.

Kategoria e dytë e cila konsumon një sasi të konsiderueshme të buxhetit të ekonomive familjare janë kostot e shërbimeve publike. Këto paraqesin një kosto prej 21 deri në 30 për qind të shpenzimeve për 25 për qind të të anketuarve.

Ndërkaq, mbi 32 për qind e të anketuarve e kanë vendosur këtë kosto në 11 deri në 20 për qind të të ardhurave të tyre totale, ndërsa, 20 për qind e të anketuarve e kanë vendosur atë në nën 10 për qind të të ardhurave. Të anketuarit me të ardhura më të ulëta e kanë vendosur këtë përqindje në nivele edhe më të larta me 11 për qind, duke e vendosur atë në nga 31 deri në 40 për qind të shpenzimit të të ardhurave të tyre totale. Është një shtresë prej 7.4 për qind që thonë se faturat e shërbimeve arrijnë deri në 50 për qind të të ardhurave të tyre.




Figura 3. Përqindja e buxhetit familjar i shpenzuar në ushqim dhe material shtëpiak si dhe në shërbimet publike

Shpenzimet për rroba dhe gjëra të tjera personale ishin dy kategoritë e tjera për të cilat pyetësi ka shtruar pyetje. Rezultatet tregojnë se për rroba dhe gjëra të tjera personale, shpenzimet nuk janë të larta. Madje, thuhet se në këtë kategori shpenzimet janë më të vogla krahasuar me shpenzimet në ushqim dhe shërbime publike të cekura më lart. Janë mbi 70 për qind e të anketuarve që deklarojnë se kanë shpenzuar më pak se 20 për qind të buxhetit të tyre në blerjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale. 18 për qind e të anketuarve pohojnë se shpenzojnë 21 deri në 30 për qind në rroba. Ndërsa, janë vetëm 8.8 për qind e të intervistuarve të cilët kanë raportuar se për rroba nuk kanë shpenzuar asgjë.

Kostoja e shpenzimeve duket të jetë e vogël edhe për argëtim e udhëtime. Përgjigjet e marra në këtë pyetje tregojnë se një pjesë e madhe e të anketuarve kanë pak kohë për argëtim. 36.3 për qind e të anketuarve raportojnë se nuk kanë shpenzuar asgjë në këto dy kategori, ndërsa mbi 40 për qind shpenzojnë në mes 1 deri 10 për qind të të hyrave për këto kategori. Një total prej 15.5 për qind e të anketuarve kanë raportuar se

për argëtim dhe udhëtime shpenzojnë 20 për qind të ta ardhurave të tyre.

Është një përqindje e vogël që kanë deklaruar për shpenzimet e tyre në këtë kategori. Vetëm 5 për qind e totalit në




Figura 5. Përqindja e buxhetit familjar i dedikuar blerjeve apo kurseve

mostër thonë se shpenzojnë për argëtim dhe udhëtime.

Figura 4 tregon një pasqyrë të qartë të shpenzimeve që bëjnë qytetarët për veshje, argëtim, e udhëtime. Kufizimet që bëjnë kosovarët gjatë blerjeve, dëshmojnë edhe nga rezultatet e arritura në pyetjen mbi paratë e shpenzuara për investime kapitale apo kurse. Për këtë qëllim, 69 për qind e të anketuarve deklarojnë se kanë shpenzuar 0 për qind të të ardhurave të tyre në




Figure 4. Përqindja e buxhetit familjar i dedikuar blerjes së rrobave, gjësendeve personale si dhe rekreacion dhe udhëtime




Figura 6. Shtete e vizituara në tre vjetët të fundit

investime apo kursime. 19.5 për qind deklarojnë se për kursime apo investime shpenzojnë deri në 10 për qind të të ardhurave. Ndërkaq, 8 për qind deklarojnë se nga buxheti i ekonomive familjare kursejnë në mes të 11 deri në 20 për qind. Përqindjet më të larta të kursimeve nga totali i buxhetit të ekonomive familjare përfaqëson më pak se 3 për qind. Udhëtimet jashtë vendit janë luks për një pjesë të rëndësishme të kosovarëve. Mungesa e lirisë së lëvizjes është pa dyshim arsyeja kryesore për paaftësinë e tyre për të udhëtuar. Për më tepër, shpenzimet lidhur me marrjen e vizave dhe shpenzimet e udhëtimit janë shumë të larta për shumicën e të anketuarve në mostër. Shumica e të anketuarve tregojnë se vendet fqinje janë destinacionet e tyre kryesore të udhëtimeve

jashtë vendit. Nga të gjitha vendet e raportuara, Shqipëria është destinacioni primar për shumicën e të anketuarve (59.9 për qind). Vendi i dytë më i vizituar siç raportohet nga të intervistuarit është Mali i Zi, i cili sipas të anketuarve arrin në 3.6 për qind. Destinacioni i tretë më i popullarizuar për t'u vizituar nga kosovarët raportohet se është Maqedonia me 2.5 për qind. Një përqindje më e vogël vërehet tek Turqia me (1.5 për qind). Kurse, zonat Schengen kanë qenë destinacion i udhëtimit për vetëm 0.8 për qind e të anketuarve në tre vitet e fundit. 30 për qind e të anketuarve nuk kanë dhënë përgjigje për këtë pyetje. E që i atribuohet personave që kanë raportuar për shpenzimet prej 0 për qind për udhëtime dhe argetim.

Llojet e tjera të kohës së lirë ose edhe të aktiviteteve të tjera luksoze janë përjetuar rrallë nga të anketuarit në mostër. Në pyetjen se sa ushqehen në restorante apo vende të tjera ku shërbehet ushqimi, 42 për qind e të anketuarve pohojnë se nuk janë ushqyer ndonjëherë në këto vende.

Ndërsa, 36.8 për qind e të anketuarve deklarojnë se kanë ngrënë jashtë shtëpive disa herë në vit. 16 për qind deklarojnë se ushqehen disa herë në muaj jashtë shtëpisë. 4.4 për qind deklarojnë se ushqehen jashtë disa herë në javë. Kurse të anketuarit të cilët





Figura 7. Frenkuetimi e të ushqyerit jashtë, apo dalje në kafene apo bare

ushqehen jashtë çdo ditë përfaqësojnë vetëm 0.6 për qind të mostrës.

Përveç se ushqehen rrallë jashtë, rezultatet tregojnë se edhe frekuentimi i kafeneve apo bareve të ndryshme gjatë natës është pothuajse i vogël. 49.5 për qind e të intervistuarve deklarojnë se ata kurrë nuk dalin natën në bare apo kafene. Një shtresë prej 22 për qind deklarojnë se dalin natën disa herë në vit. 8.1 për qind deklarojnë se dalin gjatë natës disa herë në javë. Vetëm 1.8 për qind thonë se dalin natën rregullisht.

i përket statusit shoqëror, domethënë nëse të anketuarit janë të martuar apo të pamartuar. Dallime të vogla në përgjigje vërehen edhe në aspektin e gjinisë, femrat deklarojnë dalje më të rrallë se burrat.

Figura 9 paraqet një pasqyrë vizuale të përgjigjeve të marra nga të anketuarit mbi zakonet e tyre, të ushqyerit jashtë shtëpisë dhe daljes gjatë natës.

Shkuarja në kinema nuk është aktivitet i shpeshtë për kosovarët.

Në fakt, me kaq pak kinema funksionale në




Figura 8. Frekuentimi i kinemas dhe ekspozitave



Figure 9. Shkuarja në kinema, palestër dhe ngjarje sportive

Përgjigjet e marra në këtë pyetje duket të jenë të lidhura me moshën e të anketuarve. Kjo pasi që të anketuarit e rinj në mostër deklarojnë se dalin natën më shpesh. Pyetja gjithashtu duket të jetë e njëanshme edhe sa

tërë Kosovën, shkuarja në kinema nuk është ndonjë opsion për shumicën e të anketuarve në mostër. Kjo dëshmohet edhe nga fakti se 86.6 për qind e të anketuarve nuk kanë raportuar se shkojnë ndonjëherë në kinema.

Pothuajse, 11 për qind e të anketuarve deklarojnë se shkojnë në kinema disa herë në vit, dhe një për qindje prej 1.8 për qind deklarojnë se shkojnë në kinema disa herë në muaj.

Përveq në kinema, vizitat edhe më të rralla vërehen në teatër. 92.7 për qind e të anketuarve në mostër deklarojnë se nuk kanë shkuar asnjëherë në shfaqje teatrore. 5.4 për qind e të anketuarve të përfshirë në mostër, deklarojnë se në teatër kanë shkuar disa herë në vit. Kurse vetëm 1 për qind kanë deklaruar se vizitojnë teatrot disa herë në muaj. Një pasqyrë e plotë e rezultateve të fituara mbi shkuarjen në kinema dhe teatër është paraqitur në figurën 8.

Sporti dhe ngjarjet sportive janë një formë tjetër e kalimit të kohës. Mirëpo, edhe në këtë fushë 87.1 për qind deklarojnë se asnjëherë nuk shkojnë në palestër. 6.8 për qind thonë shkojnë disa herë në vit .3.5 për qind thonë se në palestër kanë shkuar disa herë në muaj. Ndërsa, vetëm 1.3 për qind e të anketuarve deklarojnë se palestrën e vizitojnë disa herë në javë.

Në lidhje me ngjarjet sportive, situata duket

marrë pjesë në ngjarje sportive disa herë në vit. 3.8 për qind e të anketuarve deklarojnë se kanë vizituar ngjarjet sportive disa herë në muaj. Kostoja e ulët e biletave për ngjarjet sportive në Kosovë mund të jetë një faktor tjetër, përveç popullaritetit të përgjithshëm të sportit.

Figura 10 paraqet një pasqyrë lidhur me interesimin e Kosovarëve për të shkuar në palestër dhe ngjarje sportive, kulturore.

Vizitat në koncerte apo ekspozita janë edhe më të rralla për qytetarët e Kosovës në krahasim me kinema, teatër apo ngjarjet sportive. 90.4 për qind e të anketuarve thonë se nuk kanë shkuar asnjëherë në koncert apo ekspozita. Një total prej 6.9 për qind thonë se kanë marrë pjesë në koncerte apo ekspozita disa herë në vit. 1.6 për qind e të intervistuarve deklarojnë se u janë bashkuar këtyre lloj ngjarjesh disa herë në muaj. Pjesëmarrja e ulët për të vizituar ekspozitat mund të lidhet edhe më atë që në vendin tonë rrallë herë organizohen ngjarje të tilla.

Në këtë raport të intervistuarit janë pyetur edhe për interesimin e tyre për të blerë dhurata për vetë apo për të afërmit e tyre.




Figura 10. Frekuentimi i koncerteve apo ekspozitave apo blerje vetës dhe të tjerëve

të jetë pak më e mirë. 74 për qind deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë në ngjarje sportive, 20.2 për qind e të anketuarve në mostër deklarojnë se kanë

38.9 për qind e të anketuarve raportojnë se asnjëherë nuk kanë blerë dhurata për veten apo për të tjerët. 50.9 për qind e të intervistuarve deklarojnë se kanë blerë

dhurata disa herë në vit, për ditëlindje apo për data të tjera të caktuara si 8 Marsin, ditën e Shën Valentinit e të ngjashme. 9.1 për qind e të anketuarve duket të jenë të prirur (ose në gjendje më të mirë financiare) për blerjen e dhuratave për vete ose për të tjerët pasi që ata raportojnë se blerje të tilla bëjnë disa herë në muaj. Një ilustrim i plotë i përgjigjeve të ofruara për vizitat në koncerte ekspozita dhe blerjet e dhuratave është paraqitur në figurën 10.

Udhëtimet jashtë vendit ose shkuarja në pushime është një pjesë tjetër e kalimit të kohës së lirë. Për këtë qëllim, 60.6 për qind e të anketuarve deklarojnë se asnjëherë nuk kanë udhëtuar jashtë vendit. 35.5 deklarojnë se kanë shkuar në udhëtime jashtë vendit disa herë në vit. Ndërsa, 2.5 për qind e numrit të përgjithshëm të të anketuarve udhëtojnë jashtë Kosovës disa herë në muaj. Udhëtimet jashtë vendit janë zakonisht të lidhura me pushime verore për kosovarët. Kjo është konfirmuar edhe nga përgjigjet e marra në lidhje me pushimet. 39.4 për qind e të anketuarve kanë raportuar se asnjëherë nuk kanë shkuar në pushim. Disa herë, në vit është frekuenca e pushimeve të raportuara nga 58.6 për qind e të anketuarve në mostër. Vetëm 1 për qind e të anketuarve raportojnë se nuk kanë shkuar në pushim. Figura 11 jep një pasqyrë të rezultateve të

fituara në lidhje me udhëtimet jashtë vendit dhe shkuarjes në pushime.



Figura 12. Frekuentimi i kruetjes së testeve mjekësore pa ndonjë arsye

Kujdesi për shëndetin është një tjetër dimension që është mbuluar në studim. 22.7 për qind e të anketuarve në mostër deklarojnë se kurrë nuk kanë bërë teste mjekësore. 64.5 për qind e numrit të përgjithshëm e të anketuarve në mostër deklarojnë të kenë bërë testet mjekësore, me ose pa arsye disa herë gjatë vitit. 10.5 për qind e mostrës pohojnë se kanë bërë teste mjekësore disa herë në muaj. Nga rezultatet e marra arrijmë në përfundim se ndodhemi në një situatë të dobët të sistemit të shëndetit publik. Argumenti i tillë mbështetet edhe me mungesën e buxheteve familjare, të cilat mezi mjaftojnë për mbulimin e shpenzimeve elementare të jetesës si: ushqime, shërbime dhe rroba.




Figura 11. Udhëtimet jashtë vendit dhe shkuarja në pushime

Pritjet për të ardhmen e afërt

Me që perspektiva e të anketuarve për të ardhmen ndikon në sjelljet dhe praktikat e tyre atëherë në këtë raport janë parashtruar pyetje edhe për të ardhmen e tyre. Kur u pyetën për mundësinë e të mbeturit pa punë për më shumë se katër javë rresht, 42.5 për qind e kanë zgjedhur opsionin, brenda dymbëdhjetë muajve të ardhshëm. Një përqindje prej 19.5 për qind janë nga ata që janë përgjigjur se 'nuk e dinë'. Vetëm 14.8 për qind e të anketuarve në mostër janë të sigurt se humbja e vendit të tyre të punës në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm nuk është e aspak e mundshme. 23.1 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se do të mbesin pa punë për katër javë rresht ose më shumë brenda vitit të ardhshëm duke zgjedhur përgjigjen "është paksa e mundur". Kjo përbërje e përgjigjeve reflekton pasigurinë e përgjithshme për sigurinë e vendit të punës që mbizotëron në vend. Kjo i referohet të gjitha vendeve të punës në të gjithë sektorët qoftë vendeve ku paguhen mirë qoftë vendeve ku paga është më e ulët. Edhe vendet e punës brenda organizatave ndërkombëtare dhe kompanitë ndërkombëtare, të cilat konsiderohen në përgjithësi si punë të mira, janë zakonisht me kontrata afat-shkurtër deri në një vit pune. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është

edhe mungesa e të ardhurave të mjaftueshme për mbulimin e nevojave bazike brenda vitit të ardhshëm.

Pasiguria e të ardhurave në nivelin për të mos qenë në gjendje për të mbuluar nevojat themelore nuk është e mundur vetëm për 14.4 për qind të të anketuarve. 28.8 për qind deklarojnë se është "disi e mundur" që ata të mos kenë të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e tyre themelore brenda dymbëdhjetë muajve të ardhshëm. Ndërkaq, 43.7 për qind e të anketuarve e vlerësojnë këtë mundësi si shumë të mundshme. 12.8 për qind e të anketuarve nuk e din nëse do të jenë në një situatë ku nuk do të kenë të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e tyre themelore.

Nëse marrim parasysh përgjigjet e marra në lidhje me pritshmërinë e tyre si dhe me gjendjen e tyre të punësimit në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm, shqetësimet në lidhje me të qenit në gjendje për të mbuluar nevojat elementare për veten dhe familjet janë të kuptueshme. Pasiguria e tillë e lartë në lidhje me mbijetesën themelore është me të vërtetë shqetësuese për të anketuarit në mostër. Gjasat se nuk do të marrin kujdesin e duhur mjekësor brenda dymbëdhjetë

Sa është e mundur që në 12 muajt e ardhshëm të jeni i/e papunë dhe sa është e mundur që gjatë 4 javëve në vijim do të kërkonit punë?




Figura 13. Mundësia e të mbeturit pa punë dhe e nevojës për kërkim për punë në 4 javët në vijim gjatë 12 muajve të ardhshëm

A është e mundur që gjatë 12 muajve në vijim ju do të shkurtoni orarin e punës në mënyrë që të kujdeseni për ndonjë anëtarë të familjes?




Figura 14. Mundësia e largimit nga puna për t'u kujderur për anëtar të familjes

muajve të ardhshëm konsiderohet si jo e mundur për 15.5 për qind të të anketuarve.

"Deri diku të jetë e mundur", ka qenë përgjigja e kësaj pyetjeje e dhënë nga 37.3 për qind të të anketuarve. Ndërsa, 3.6 për qind e të anketuarve një mundësi të tillë e kanë vlerësuar si shumë të mundshme. 13.6 për qind, nuk e din nëse ata do të marrin shërbime mjekësore në rast se u nevojiten gjatë vitit të ardhshëm.

Përceptimi mbi Dihmën dhe Shërbimet Sociale

Ky seksion mbulon përceptimet e qytetarëve mbi ndihmën dhe shërbimet e ofruara nga shërbimet publike sociale. Sigurimet shëndetësore dhe pensionerët, ishin pjesë e pyetjeve të përfshira për të vlerësuar përceptimet e qytetarëve lidhur me sistemin e sigurimeve shoqërore në Kosovë. Ndërsa, përceptimet mbi disponueshmërinë e shërbimeve shëndetësore janë një tregues në vetvete i rëndësishëm se si ndihen të anketuarit në lidhje me sistemin shëndetësor në Kosovë. Aspektet tjera të trajtuara në këtë seksion sigurojnë një kuptim më të gjerë të perceptimeve të qytetarëve. Të anketuarit u

pyetën edhe për familjet në nevojë që janë përfituese aktuale të asistencës sociale. 30.5 për qind e të anketuarve aspak nuk pajtohen. 7.2% e të anketuarve deklarojnë se nuk e din ku shpëndahehet asistenca sociale, perceptimi i përgjithshëm në drejtim të ndihmës sociale, komunikimi nëpërmjet përgjigjeve të kësaj pyetje është i zyrtë. Të anketuarit janë pyetur edhe se si ata e shohin qëndrueshmërinë dhe pamjen e sistemeve të pensioneve dhe kujdesit shëndetësor. Për këtë qëllim, të anketuarit janë pyetur që ti paraqesin opinionet e tyre se a do të jetë Kosova në gjendje që familjet në nevojë aktualisht janë përfitues të ndihmës sociale, ndërsa një tjetër përqindje prej 29.5 për qind e të anketuarve tregojnë mospajtim me këtë. Të dy kategoritë që shprehin mospajtim me këtë pyetje përbëjnë 60 për qind të respondentëve në mostër. Është e rëndësishme të theksohet se vetëm 3.4 për qind e totalit të të anketuarve të përfshirë në anketë plotësisht dakordohen se ndihma sociale është e adresuar tek familjet me më së shumti nevojë në shoqëri. Me këtë deklaratë pajtohen vetëm 11.8 për qind. Ndërsa, 17.5 për qind deklaruan se janë neutral në këtë pyetje. Përderisa, 7.2 për qind e të anketuarve deklaruan se nuk dinë se ku është shpërndarë asistenca sociale,

A është e mundur që gjatë 12 muajve të ardhshëm të ketë periudha kur ju nuk keni të ardhura të majsfutueshme për të mbuluar nevojat bazë të familjes suaj?




Figura 15. Gjasat për periudha me të ardhura të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat themelore të familjes në 12 muajt e ardhshëm

A është e mundur për të mos marrë shërbime mjekësore që ju duhen në qoftë se ju sëmureni gjatë 12 muajve të ardhshëm?




Figura 16. Mundësia e marrjes së shërbimeve mjekësore nëse sëmundeni në 12 muajt e ardhshëm

përceptimi i përgjithshëm ndaj asistencës sociale është i zyrtë.

Të anketuarit janë pyetur se si ata e shohin qëndrueshmërinë e sistemit pensional dhe kujdesit shëndetësor. Për këtë qëllim ata janë pyetur nëse Kosova do të jetë në gjendje të përballojë koston e shërbimeve të shëndetit publik. Përgjigjja e parë e marr lidhur me këtë është se: Kosova nuk do të jetë në gjendje të mbajë këtë nivel të këtyre shërbimeve pasi që këto shërbime janë të kushtueshme. Përgjigjja e dytë e të anketuarve është se : Kosova do të jetë në gjendje për ta ruajtur nivelin aktual të shërbimeve, por nuk do të jetë në gjendje të përmirësojë ato. Mendimi i tretë është më




Figura 17. Asistencën sociale a ka shkuar tek familjet me më në nevojë?

optimist për sa i përket të ardhmes së dhënë. Thuhet se: Kosova do të jetë në gjendje të investojë në përmirësimin e këtij sistemi. 27.5 për qind e të anketuarve në mostër besojnë se Kosova nuk do të jetë në gjendje të përballojë edhe ruaj nivelin aktual të shërbimeve. 34.7 për qind e të anketuarve mendojnë se niveli aktual i shërbimeve do të mbahet, por nuk do të ketë përmirësime në të ardhmen e afërt. Ndërsa, 14.5 për qind mendojnë se Kosova do të jetë në gjendje jo vetëm për të ruajtur por edhe për ta përmirësuar nivelin aktual të shërbimeve të ofruara nga shërbimet publike. Pothuajse një e katërta e të gjithë të anketuarve në mostër u përgjigj "nuk e di". Një pasqyrë e plotë vizuale e përgjigjeve është dhënë në

figurën 18. Një pyetje është shtruar edhe në lidhje me pensionet të cilat paraqesin një prej linjave më të mëdha të buxhetit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë. Për këtë qëllim, 23.4 për qind




Figura 18. Parashikimi afatshkurta mbi koston e shërbimeve shëndetësore services

janë pesimistë se Kosova mund të mbajë nivelet aktuale të pensioneve bazë. 36.5 për qind e të anketuarve në mostër konsiderojnë se nivelet aktuale të pensioneve bazë mund të mbahen por nuk do rriten në të ardhmen e afërt. Pothuajse, çdo i pesti respondent në mostër (19 për qind) mendon se Kosova do të jetë në gjendje të përballojë rritjen e pensioneve në të ardhmen e afërt si dhe të mbajë nivelet aktuale. Janë 21 për qind e të anketuarve të mostrës që nuk e dinë nëse Kosova do të jetë në gjendje të përballojë faturën e pensioneve themelore në të ardhmen e afërt. Përgjigjet e marra për këtë çështje janë paraqitur në figurën 19.




Figura 19. Kostoja afatgjatë e pensioneve

KONKLUZIONE & REKOMANDIME

Studimi tregon për një situatë tepër të vështirë financiare dhe sociale të mostrës përfaqësuese në Kosovë dhe jep një informacion të gjerë mbi mënyrën e jetesës dhe pritjet e kosovarëve. Shumica e të anketuarve në mostër pjesën më të madhe të të ardhurave të tyre e shpenzojnë në ushqim, konsum dhe shërbime komunale. Për një pjesë të madhe të të intervistuarve, shpenzime themelore përfaqësojnë pjesën më të madhe të buxheteve të tyre, me pak ose aspak të holla të mbetura për shpenzimet për kohën e lirë ose për luks.

Për shkak të një situatë mjaft të kufizuar financiare, shumica e kosovarëve nuk marrin pjesë në ngjarjet shoqërore, sportive, ekspozita apo koncerte. Ata gjithashtu rrallë hanë jashtë shtëpive ose angazhohen në mënyrë aktive në jetën e natës. Mbi 60 për qind e të anketuarve nuk kanë udhëtuar jashtë vendit gjatë vitit të kaluar. Kurse, 40 për qind kanë udhëtuar kryesisht duke vizituar vendet fqinje. Vetëm 1 për qind e numrit të përgjithshëm e të anketuarve në mostër janë nga ata që kanë vizituar një vend të BE-së gjatë vitit të kaluar. Cilësia e dobët e jetës konfirmohet më tej nga fakti se pothuajse 40 për qind e të anketuarve raportojnë se asnjëherë nuk kanë shkuar në pushime.

Buxhetet e stërngarkuara, familjarëve mezi ua mundësojnë një jetë të mirë sociale. Kur varfëria kulturore dhe sociale e paraqitur më sipër është e kombinuar me të ardhmen e mjerë ekonomike e cila bazohet në pasigurinë e

lartë të punësimit në vend, atëherë ajo bëhet edhe më shqetësuese.

Niveli aktual i të ardhurave nuk jep sigurinë e përmbushjes së nevojave themelore në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë. Mbi 70 për qind e të anketuarve raportojnë se nuk janë në gjendje për të kursyer apo për të investuar asgjë nga të ardhurat e tyre, një kosto e papritur do të mund ti nxjerr ata jashtë bilancit financiar e që e bën të pamundur për të mbuluar kostot themelore të jetesës.

Të perceptuarit mbi paanësinë e sistemit në Kosovë, i cili është vlerësuar me anë të këtij studimi, duket se mungon në perceptimet e të anketuarve të përfshirë në mostër. Përderisa një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve nuk janë të sigurt nëse ata do të marrin shërbimet/ trajtimet mjekësore në rast nevojë gjatë vitit në vijim, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve shprehen pesimist se do ti kenë këto shërbime në dispozicion. Për më tepër, shumica e kosovarëve nuk mendojnë se fondet e ndihmës sociale i shërbejnë atyre që janë me nevojë në shoqërinë kosovare. Skema e pensioneve bazë dhe sistemi aktual i shërbimit shëndetësor janë perceptuar nga të anketuarit si mjaft të qëndrueshme, por në anën tjetër shumë pak të anketuar në të vërtetë janë optimistë se shërbimet do të përmirësohen dhe pensionet do të rriten. Vështirësitë aktuale dhe pasiguria për të ardhmen të shoqëruara me shumë pak aktivitete sociale dhe aktivitete të kohës së lirë e bëjnë cilësinë e jetës së

kosovarëve nën standardet normale. Mungesa e burimeve financiare, mungesa e aftësisë për të udhëtuar, ngjarjet sportive të shtrenjta dhe të rralla si dhe ngjarjet kulturore, të gjitha këto kontribuojnë në një situatë të përgjithshme në vend në lidhje me situatën aktuale. Ekziston një nevojë e madhe për të rivendosur besimin dhe optimizmin për të ardhmen për shumicën e të anketuarve në mostër, pasi që ata paraqesin pritshmëri shumë të ultë për të ardhmen. Në mënyrë që të bëhet kjo, ndryshimi sistematik është më se i nevojshëm dhe ndërhyrjet shumë nivelëshe dhe multidimensionale janë të nevojshme.

Përderisa, Qeveria e Kosovës nuk mund të ndikojnë në të ardhurat e njerëzve drejtpërdrejtë, duhet të merren politika për mbrojtjen e kategorive më të rrezikuara të punëtorëve që janë të gatshëm të punojnë për paga minimale. Pagesa minimale për punë me orar të plotë, duhet të rritet në mënyrë që njerëzit që punojnë për paga minimale të mund të kenë aftësinë për t'i mbuluar nevojat e tyre themelore, në mënyrë sistematike, Ministria për Punë, dhe Mirëqenie Sociale (MPMS) duhet të përmirësojë komunikimin me qytetarët, duke ofruar një shpjegim të qartë të skemave të mbrojtjes sociale, pasi që niveli aktual i informimit nga të intervistuarit në këto tema është shumë i ulët. Përderisa të ardhurat e disponueshme të qytetarëve varen nga shumë faktorë, ofrimi i mundësisë për të marrë pjesë në aktivitete të kohës së lirë pa pagesë do të përmirësojë cilësinë e jetës së tyre në mënyrë të konsiderueshme. Për këtë qëllim,

organizimi i ngjarjeve publike si koncerte, shfaqje teatrale apo ngjarje sportive në hapësirat publike do të pasurojë jetën sociale të kosovarëve. Kjo është veçanërisht e vlefshme për qytetet më të vogla dhe vendbanimet ku popullsia i ka mundësitë edhe më të kufizuara.

Në disa zona/fshatra në Kosovë, jeta shoqërore është e kufizuar në dasma që ndodhin gjatë verës, ndërsa në nëntë muajt e tjerë të vitit qytetarët dhe të rinjtë në veçanti, nuk kanë mundësi të ndjekin ngjarje shoqërore. Institucionet, në veçanti Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) duhet të investojë më shumë në organizimin e ngjarjeve publike pa pagesë për të inkurajuar pjesëmarrjen edhe nga individët me të ardhura të ulëta. Nga ana tjetër, MPMS ose MKRS gjithashtu mund të japin bileta falas për hyrje në ngjarje të tilla për personat me të ardhura më të ulëta ose pa të ardhura në përgjithësi.

Besimi në sistemin e mbrojtjes sociale dhe kujdesin shëndetësor duhet të rivendoset. Nëse përfitimet e qytetarëve nga shërbimet e ofruara nga institucionet publike kanë për qëllim përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, imazhi i tyre i keq publik është një pengesë e madhe në arritjen e këtij qëllimi. Skandalet e shumta që përfshijnë institucionet shëndetësore publike janë identifikuar si arsye kryesore për mosbesimin e qytetarëve, por edhe përvojat personale me institucionet në fjalë justifikojnë një paragjykim të tillë.



Projekti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Implementuar nga:

